

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikacryl®-200

IZOLUES AKRILIK ME PERFORMANCË TË LARTË PËR APLIKIME NË MJEDISE TË BRENDSHME E TË JASHTME



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikacryl®-200 është izolues akrilik me 1 përbërës dhe me bazë uji për fuga me lëvizje të ulët dhe mbushje të plasaritjeve. Mund të aplikohet pa prajmer dhe ngjitet mirë mbi materiale të ndryshme ndërtimi, ka rezistencë ndaj shiut dhe mund të lyhet. Aftësia e lëvizjes ±12,5 %. Përdorim i brendshëm dhe i jashtëm.

PËRDORIMET

Izolime:

- Fugat mbi shumë lloje nënshtresash me lëvizje të moderuar
- Lidhjeve përreth kasave të dyerve dhe dritareve, tubave prej PVC-je
- Përreth depërtimeve të mureve dhe tavaneve

Mbushje plasaritjesh:

- Plasaritje që nuk janë të ekspozuara në prani të përhershme uji

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- 1 përbërës, gati për përdorim
- Mund të lyhet
- Ndërkapje e mirë mbi nënshtresa të ndryshme
- I transportueshëm në -10 °C (max. 24 orë)
- Për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm
- Rrjedhë e mirë varjeje
- Aftësia e lëvizjes ±12,5 %
- Rezistencë ndaj shiut

MIRATIME / STANDARDE

- Markë CE dhe Deklaratë Performance sipas EN 15651-1 - Izolues për përdorim jostrukturor në fugat e ndërtesave - elementeve të fasadave

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	akrilik me 1 përbërës
Ambalazhi	tubetë 300 ml, 12 copë/ kuti
Ngjyra	E bardhë
Jetëgjatësia	18 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të mbyllur, në kushte të thata dhe temperatura midis +5 °C dhe +25 °C. Lexoni gjithmonë ambalazhin.
Dendësia	~1,60 kg/l (ISO 1183-1)

TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore A	~35 (pas 28 ditësh)	(ISO 868)
Aftësia për lëvizje	± 12,5%	(ISO 11600)

Temperatura e funksionimit	-25 °C deri në +70 °C (i thatë)						
Projektimi i fugës	Përmasat e fugave duhet të projektohen në mënyrë që të përshtaten me aftësinë e izoluesit për lëvizje. Gjerësia e fugës duhet të jetë ≥ 10 mm dhe ≤ 15 mm. Duhet të ruhet një raport gjerësi me thellësi 2:1 (për përjashtimet, shih tabelën më poshtë). <table border="1"> <thead> <tr> <th>Gjerësia min. e fugës [mm]</th> <th>Thellësia min. e fugës [mm]</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>10</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>15</td> <td>10</td> </tr> </tbody> </table> <p>Profilet trekëndore të fugave duhet të kenë anë për ngjitje ≥7 mm. Për fuga më të gjera, kontaktoni me shërbimin teknik të Sika-s për informacione shtesë.</p>	Gjerësia min. e fugës [mm]	Thellësia min. e fugës [mm]	10	10	15	10
Gjerësia min. e fugës [mm]	Thellësia min. e fugës [mm]						
10	10						
15	10						
Kompatibiliteti	Beton, aerobeton, suva, çimento me fibra, tulla, pllaka gipsi, alumin, PVC, dru						

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	Gjatësi fuge [m] për 300 ml	Gjerësi fuge [mm]	Thellësi fuge [mm]
	3,0	10	10
	2,0	15	10

Formula e përlogaritjes së konsumimit
Gjatësia e fugës [m] = 280 ml / (gjerësi fuge [mm] x thellësi fuge [mm])
Litra / Metër linear fuge = (gjerësi fuge [mm] x thellësi fuge [mm]) / 1000 [m x mm² / l]
Konsumimi varet nga ashpërsia dhe absorbueshmëria e nënshtresës.
Këto vlera janë teorike dhe nuk përlogarisin asnjë material shtesë të kërkuar për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel, apo firon, etj.

Rrjedha e varjes	< 1 mm (23 °C)	(ISO 7390)
Temperatura e mjedisit	+5 °C deri në +30 °C, min. 3 °C mbi temperaturën e pikës së vesës.	
Temperatura e nënshtresës	+5 °C deri në +30 °C	
Ritmi i maturimit	~2 mm/24 orë (+23 °C / 50% lagështi relative)	(CQP* 049-2) *Sika Corporate Quality Procedure
Koha e krijimit të kores	~15 minuta (+23 °C / 50% lagështi relative)	(CQP 019-1)

UDHËZIME APLIKIMI

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e pastër, e thatë, e qëndrueshme dhe homogjene, pa vaj, graso, pluhur dhe grimca të lira ose të shkrifëta. Sikacryl®-200 ndërkapet pa prajmer dhe/ose aktivizues. Për nënshtresa poroze, p.sh. betoni, suvaja dhe/ose druri, Sikacryl®-200 mund të tretet në ujë (në raport 1:1 deri në 1:5) dhe të përdoret si një prajmer nëse nevojitet. Mbi plastikën dhe bojërat, duhet të kryhen teste ndërkapjeje përpara aplikimit. Hekuri dhe çeliku duhet të mbrohen me prajmer kundër korrodimit.

PËRZIERJA

1 përbërës gati për përdorim

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Maskimi

Rekomandohet përdorimi i shiritave maskues aty ku nevojiten vija të sakta dhe të drejta fugash. Hiqni shiritin brenda kohës së krijimit të kores.

Aplikimi

Sikacryl®-200 është gati për përdorim. Përgatitni fundin e tubetës, vendoseni tek pistoleta dhe mbërtheni majën. Nxirrni Sikacryl®-200 brenda fugës ose përreth lidhjes duke u siguruar se vjen në kontakt të plotë me anët e fugës ose sipërfaqet ngjitur dhe se është shmangur bllokimi i ajrit.

Finirimi

Sa më shpejtë të jetë e mundur pas aplikimit, izoluesi duhet të ngjeshet fortë në anët e fugës për të siguruar ndërkapje të mjaftueshme dhe finiturë të niveluar. Përdorni ujë për të niveluar sipërfaqen e fugës. Mos përdorni produkte përpunimi mekanik që përmbajnë

tretës.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

- Tabela e trajtimit paraprak për izolimin dhe ngjitjen

KUFIZIME

- Edhe pse Sikacryl®-200 ka rezistencë ndaj shiut, nuk duhet të aplikohet ndërsa është duke rënë shi.
- Ndryshimi i ngjyrës mund të ndodhë për shkak të ekspozimit ndaj kimikateve, temperaturave të larta dhe/ose rrezatimit UV (kryesisht në ngjyrën e bardhë). Ky efekt është estetik dhe nuk ndikon negativisht në performancën teknike apo në rezistencën e produktit.
- Sikacryl®-200 mund të lyhet me shumicën e sistemeve konvencionale të veshjes me bojë të fasadave. Megjithatë, duhet të testohet kompatibiliteti i bojërave duke kryer testime paraprake (p.sh. sipas dokumentit teknik ISO: Mundësi lysterje dhe kompatibiliteti i bojërave me izoluesit). Përftohen rezultate më të mira kur izoluesit është tharë plotësisht. Shënim: sistemet e bojërave jofleksibël, mund të dëmtojnë elasticitetin e izoluesit dhe të shkaktojnë plasaritje mbi veshjen e bojës.
- Të mos përdoret mbi nënshtresa bituminoze, gomën natyrore, gomën EPDM apo mbi materiale ndërtimi të cilat mund të lëshojnë vajra, plastifikatorë apo tretës që mund të degradojnë izoluesin.
- Të mos përdoret si izolues xhamash, për fugat e dyshemeve ose të pajisjeve hidrosanitare, mbi mermer, gurin natyror apo në strukturat e inxhinierisë së ndërtimit.
- Të mos përdoret për fugat nën presion uji ose në zhytje të përhershme në ujë.
- Nuk rekomandohet aplikimi gjatë ndryshimeve të mëdha të temperaturave (lëvizje gjatë tharjes).

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikacryl®-200

Shtator 2019, Botimi 02.01

02051404000000055

Sikacryl-200-sq-AL-(09-2019)-2-1.pdf

